

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
KP 55/11
03.03.2011

Trupi gjykues prej tre anëtarëve i Gjykatës së qarkut në Prizren i përbërë prej gjyqtarit Malcolm Simmons kryetari i trupit gjykues, gjyqtarëve Vaton Durguti dhe Kujtim Pasuli si anëtarët e trupit gjykues, në lëndën penale kundër

1. B. K. , emri i të atit R. , emri i nënës , i vajzërisë , i lindur më në fshatin , komuna e Podujevës, tani në , rruga shqiptar kosovar, i martuar, babai i dy fëmijeve, i diplomuar nga Fakulteti i Juridikut, me gjendje të mesme ekonomike, nuk dihet për dënime të mëparshme në Kosovë, tanimë në liri, dhe

2. X. D. , emri i të atit , emri i nënës i vajzërisë , i lindur më në tani me vendbanim në shqiptar kosovar, i ve, babai i tre fëmijeve, i diplomuar nga Fakulteti i Juridikut, me gjendje të mesme ekonomike,

të akuzuar sipas aktakuzës PP numër 2549-15/08 të datës 4.06.2008, me të cilin i pandehuri B. Kr (në tekstin e mëtutjeshëm "I pandehuri i parë") ishte i akuzuar më parë për veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 i Kodit penal të Kosovës të përkohshëm (në tekstin e mëtutjeshëm "KPKP") dhe i pandehuri X. (në tekstin e mëtutjeshëm "I pandehuri i dytë") është akuzuar për veprën penale shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2, dhe veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 348 par.2 i KPKP,

duke vendosur sipas ankesës së prokurorit publik komunal në Prizren me datën 2.02.2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës komunale në Prizren në lëndën me numër P. 616/10 të datës 15.12.2010, pas seancës me datën 3.03.2011 ku ishte i pranishëm i pandehuri i parë dhe i pandehuri i dytë përfaqësohej nga Ymer Osaj, në pajtim me nenin 423 të Kodit të procedurës penale të Kosovës, shpall këtë

AKTGJYKIM

Refuzohet ankesa si a pabazuar dhe me këtë vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës komunale në Prizren në lëndën me numër P. 616/10 të datës 15.12.2010.

Arsyetimi

I pandehuri i parë ishte i akuzuar se me datën 6.09.2007 në cilësinë e gjyqtarit për konfirmim i Gjykatës së qarkut në Prishtinë, në seancën e konfirmimit të aktakuzës PP.nr.855-2/07 të datës 19.07.2007, me qëllim që të shkaktoj dëm palës së dëmtuar E. , A. , B. G. dhe M. D. me qëllim që të mohoj të drejtën e tyre të paditësve subsidiare, nuk thirri të pandehurin I B. dhe palët e dëmtuar në pajtim me dispozitat e nenit 313 par. 2 të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm "KPPPK"), duke nxjerr vendimin e kundërligjshëm me konfirmimin e aktvendimit KA.nr.357/07 të datës 6.09.2007 aktakuzën e re të dorëzuar nga i pandehuri i dytë, kinse është dorëzuar në gjykatë me datën 19.07.2007 e cila nuk e përfshinte të akuzuarin Q B. dhe I. B. të akuzuar për veprën penale lëndime të rënda trupore nga neni 154 par. 1 pika 5 i KPKP, dhe nuk e njoftoi palën e dëmtuar për të drejtat e tyre të ndjekjes së akuzave penale në pajtim me 62 par. 1 të KPPPK.

Me çka pohohet se i pandehuri i parë ka kryer veprën penale nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore nga neni 346 i KPKP.

I pandehuri i dytë ishte i akuzuar se me datën 6.09.2007 në zyrën me : së qarkut në Prishtinë, në cilësinë e gjyqtarit të qarkut në Prishtinë, dhe prandaj "person zyrtar" përbrenda kuptimit të Kodit, gjatë seancës së konfirmimit të aktakuzës së Prokuroritë publike të qarkut në Prishtinë PP.nr.855-2/07, e shpërdori pozitën e vet zyrtare dhe i tejkaloi autorizimet e veta zyrtare me qëllim që të shkaktoj dëm palës së dëmtuar E. , A. , B. G. dhe M. D. të mohoj të drejtën e tyre të ndjekjes së akuzave penale, me shkelje të dispozitave të nenit 313 të KPPPK, i nxitur nga i pandehuri i parë, e ndryshoi

aktakuzën e përmendur ashtu që më nuk akuzoheshin të akuzuarit Q. B. i dhe I. B. për veprën penale të lëndimeve të rënda trupore nga neni 154 par. 1 pika 5 e KPKP, për çka është akuzuar në aktakuzën e dërguar gjykatës me datën 19.07.2007.

Me çka pohohet se i pandehuri i dytë ka kryer veprën penale shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.2 i KPKP.

Më tej pretendohet kundër të pandehurit të dytë se në ditën e njëjtë dhe derisa vepronte në cilësinë e njëjtë e përdori si origjinal dokumentin e falsifikuar zyrtar, d.t.th aktakuzën PP.nr.855-2/07 ku shënonte fals se aktakuza ishte dërguar në gjykatë me datën 19.07.2007 në ora 15:20 me numër reference 617 dhe nga aty ishte dorëzuar të pandehurit të parë i cili e dërgoi si origjinal në shkresat e lëndës të Gjykatës së garkut në Prishtinë KAQ.nr.375/07.

Me çka pohohet se i pandehuri i dytë ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 348 par.2 i KPKP.

Sikurse kundër të pandehurit të parë, duke e zbatuar parimin *reformationis in peius*, gjykata e ri-kualifikoi akuzën e nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore nga neni 346 i KPKP si shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit dhe jo për veprën nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 346 i KPKP).

Me datën 15.12.2010 Gjykata komunale në Prizren lëshoi një aktgjykim me të cilin i pandehuri i parë ishte liruar nga vepra shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 (2) të KPK dhe i pandehuri i dytë ishte liruar nga vepra shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 (2) të KPK por u dënua për falsifikim të dokumenteve zyrtare nga neni 348 (2) i KPK dhe u dënua me burgim prej tre muajve, i pezulluar për një vit.

Prokurori parashtroi një ankesë me datën 2.02.2011 kundër aktgjykimit të shkallës së parë me të cilën pohohej se gjykata e shkallës së parë përcaktoi provat në mënyrë të pjesshme dhe të gabuar.

Mbrojtja e të pandehurit të parë dhe të dytë parashtroi përgjigjet ankesës së prokurorit. I pandehuri i dytë nuk u ankua për dënimin e tij nga neni 348 (2) i KPK.

Ne nuk propozojmë këtu përsëritjen e të gjitha të gjeturave faktike të gjykatës së shkallës së parë.

I pandehuri i parë ishte i akuzuar me akuzën e parë shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe i autorizimit nga neni 339 (2) i KPK.

I pandehuri i dytë ishte i akuzuar me dy akuza: e para, shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe i autorizimit nga neni 339 (2) i KPK dhe, e dyta, falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 348 (2) i KPK.

i. Shpërdorimi i pozitës zyrtare dhe i autorizimit nga neni 339 i KPK

Neni 339 (1) shënon

Personi zyrtar i cili, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete, ose për tjetrin ose për organizatën afariste ose të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë afariste, shpërdoron pozitën e tij/saj zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.

Neni 339 (2) shënon

Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëmin i cili tejkalon shumën prej 2.500 EUR apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tre vjet.

Ekzistojnë dy pjesë të veprës nga neni 339. E para, a ka pasur për qëllim i pandehuri përfitimin e kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose shkaktimin e dëmit personit tjetër? E dyta, a e ka

shpërdorur i pandehuri pozitën e tij zyrtare, tejkaluar kompetencat ose nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare?

Ekziston një dallim i qartë midis qëllimit themelor dhe i veçantë. Vepra nga neni 339 kërkon qëllimin e veçantë. Prandaj, prokuroria duhet të dëshmoj se i pandehuri konkretisht pati për qëllim përfitimin e kundërligjshëm të dobisë materiale për vete ose për tjetrin ose shkaktimin e dëmit personit tjetër. E dyta, nëse prokuroria me sukses e dëshmon pjesën e parë të testit atëherë duhet të dëshmoj se i pandehuri shpërdoroi pozitën e tij zyrtare, dhe/ose tejkaloi kompetencat e tij dhe/ose nuk i përmbushi detyrat e tij zyrtare.

Personi ka për qëllim një pasojë kur ai ose ajo e parasheh se ajo do të ndodh nëse një seri i veprimeve ose i lëshimeve të dhëna vazhdojnë dhe dëshiron të ndodhin.

Ekziston një dallim midis qëllimit themelor dhe të veçantë.

Veprat që kërkojnë qëllimin themelor veçojnë elementin mens rea e cila nuk është asgjë më shumë se një lëshim i qëllimshëm ose i pakujdesshëm i *actus reus*. Aktori e dinte ose me qëllim nuk mendoi për rrezikun se veprimet e tija do të rezultonin në dëmin e pësuar nga viktimi.

Prandaj, gjatë vendosjes nëse një person ka kryer një vepër, gjykata nuk do të detyrohet me ligj të nxjerr përfundime se ai ka pasur për qëllim ose ka paraparë rezultatin e veprimeve të tija vetëm pse kjo është pasojë natyrale e atyre veprimeve por do të vendos nëse ai ka pasur për qëllim ose ka paraparë rezultatin duke i referuar të gjitha provave, duke nxjerrë përfundime të tilla të duhura sipas rrethanave.

Mirëpo, një numër i kufizuar i veprave përkufizohen që të kërkojnë një element më shumë përveç qëllimit themelor - qëllimi i veçantë.

Veprat e veçanta mund të jenë aq të rënda sa që kërkesat mens rea duhet të përpilohen për të demonstruar më saktësisht ku ndodhet gabimi. Pra, përveç mens rea së zakonshme të qëllimit ose të pakujdesisë, kërkohet një element më shumë ose shtesë.

Rregulla në rastet që përfshijnë veprat e tilla është se elementi themelor mund të dëshmohet në mënyrë të zakonshme,

por elementi i qëllimit të veçantë duhet të tregohet duke përdorur testin i cili është më shumë subjektiv se sa objektiv prandaj duke u siguruar që kërkesat e caktuara të ligjbërësit të plotësohen.

Neni 339 kërkon dëshminë e qëllimit të veçantë.

Prandaj, prokuroria duhet të dëshmoj se i pandehuri konkretisht ka pasur për qëllim dëmin e shkaktuar. Ky është testi subjektiv nga neni 339.

Nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për të gjetur se i pandehuri i parë dhe/ose i dytë konkretisht ka pasur për qëllim përfitimin e kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose se ai ka pasur për qëllim shkaktimin e dëmit një personi tjetër ose një organizate afariste.

ii. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 348 (2) i KPK


I pandehuri i dytë është dënuar me akuzën e parë falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 348 (2) i KPK. Ai nuk u ankua për dënimin e tij.

Prandaj vendoset sipas...

Gjyqtari Malcolm Simmons
Kryetari i trupit gjykues

Gjyqtari Vaton Durguti
Anëtari i trupit gjykues

Gjyqtari Kujtim Pasuli
Anëtari i trupit gjykues



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Kosova Cumhuriyeti
TASDİK EDİLMİŞ KOPYAYININ AŞLINA UYGUN OLDUĞU TASTIRILIR
BU KOPYAYININ AŞLINA UYGUN OLDUĞU TASTIRILIR

Pretori i autoritetit
Ovlašćenik
Metković